



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK**

VENDIM

Nr 25 date 25.11.2019

PER PAKETEN FISKALE 2020

Keshilli i Bashkise Shijak ne mbledhjen e tij te dates 25/11/2019 mori ne shqyrtim Projekt –Vendimin “Per Miratimin e Paketes Fiskale per vitin 2020 bazuar ne ligjet vendimet dhe udhezimet e meposhtme:

- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”*, ndryshuar me Ligjin nr. 9745 datë 28.05.07; ndryshuar me Ligjin nr. 9764, datë 09.07.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9931, datë 09.06.2008; ndryshuar me Ligjin nr. 10 073, datë 9.2.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10117 dt. 23.4.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10146 dt.28.9.2009; ndryshuar me Ligjin Nr. 10354 , datë 18.11.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10457, datë 21.07.2011; ndryshuar me Ligjin nr. 106/2013, datë 28.3.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 85/2014, datë 17.07.2014; ndryshuar me Ligjin nr. 181/2013, dt. 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015;
- Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*
- Ligji 68/2017 date 27/04/2017 *“Per financat e vetqeverisjes vendore”*
- Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998, *“Për tatimin mbi të ardhurat”*, i ndryshuar. ndryshuar me Ligjin nr. 9483, datë 16.2.2006, ndryshuar me Ligj Nr. 9632, datë 30.10.2006; ndryshuar me Ligjin nr. 9716 datë 16.04.2007; ndryshuar me Ligjin Nr. 9735 datë 17.05.2007; ndryshuar me ligj nr. 9766 datë 09.07.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9804 datë 13.09.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9844 datë 17.12.2007; ndryshuar

- me Ligjin nr. 9943, datë 26.6.2008; ndryshuar me Ligjin nr.10072, datë 9.2.2009; ndryshuar me Ligjin nr.10228, datë 4.2.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10364, datë 16.12.2010; ndryshuar me Ligjin Nr. 20/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me Ligjin nr. 71/2012, datë 28.6.2012; ndryshuar me Ligjin Nr. 122/2012, datë 20.12.2012; ndryshuar me Ligjin Nr. 107/2013, datë 28.3.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 124/2013, datë 25.4.2013; ndryshuar me Ligjin Nr. 177/2013, datë 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin Nr. 32/2014, datë 3.4.2014; ndryshuar me Ligjin Nr. 42/2014, datë 24.4.2014; ndryshuar me Ligjin Nr. 83/2014, datë 17.07.2014; ndryshuar me Ligjin nr. 156/2014, dt. 27.11.2014;
- Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 *“Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”*;
 - Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar;
 - Ligji nr.10081, datë 23.2.2009, *“Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar”;
 - Ligji nr. 10304, datë 15.7.2010, *“Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”*;
 - Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008 *“Për taksat kombëtare”*, i ndryshuar me Ligjin Nr.10 065, datë 29.1.2009, ndryshuar me Ligjin Nr. 10 131 dt. 11.5.2009, ndryshuar me Ligjin nr. 10145, datë 28.9.2009, ndryshuar me Ligjin nr.10280, dt.20.5.2010, ndryshuar me Ligjin Nr. 10458, datë 21.7.2011. ndryshuar me Ligjin Nr. 83/2012, datë 13.9.2012. ndryshuar me Ligjin Nr. 120/2013, datë 18.04.2013. ndryshuar me Ligjin Nr. 178/2013, datë 28.12.2013. ndryshuar me Ligjin Nr. 86/2014, datë 17.07.2014, ndryshuar me Ligjin Nr. 157/2014, datë 27.11.2014;
 - Ligji nr. 93/2015 *“Për turizmin”*;
 - Ligji Nr. 9482, datë 03.04.2006 *“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”*, i ndryshuar;
 - Ligji nr. 107/2014 *“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”*;
 - Ligji nr.10 465, datë 29.9.2011 *“Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”*;
 - Ligji nr.8450, datë 24.2.1999 *“Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”*, i ndryshuar;
 - Ligji. nr. 9385, datë 4.5.2005 *“Për pyjet dhe shërbimin pyjor”*;
 - Ligji nr. 9693, datë 19.3.2007 *“Për fondin kullësor”*, i ndryshuar;
 - Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 *“Për kundravajtjet administrative”*;
 - Ligji nr.8744, datë 22.2.2001 *“Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”*, i ndryshuar me Ligjin Nr.9561, datë 12.6.2006 dhe Ligjin Nr.9797, datë 23.7.2007;
 - Ligji Nr.10296, datë 08/07/2010, *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*;
 - Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, *“Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”*, i ndryshuar;
 - Ligji nr. 152/2015, datë 21.12.2015, *“Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”*.
 - Ligjin nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit,*

- Ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë";
- Ligjin nr. 9774, datë 12.07.2007 "Për administrimin dhe vlerësimin e zhurmës në mjedis", i ndryshuar me Ligjin nr. 39/2013;

Vendime dhe udhëzime:

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 1.8.2007 "Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 783, datë 10.11.2011, "Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore";
- VKM nr. 7, datë 4.01.2012, "Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare", i ndryshuar.
- VKM nr. 970, dt. 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj";
- V K M nr. 396, datë 21.6.2006 "Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore";
- VKM nr. 391 datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave";
- VKM nr. 632 datë 11.06.2009 "Për tarifën në sektorin e Kullotave",
- VKM nr. 1064 datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në VKM nr. 391 datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave";
- V K M nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik";
- VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 992, datë 9.12.2015 "Për disa ndryshime në vendimin nr.54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar;
- VKM nr. 469, datë 3.6.2015, "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore";
- VKM nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte";
- VKM nr. 285, date 27.6.2002 "Për tarifën e shërbimeve që kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridikë e fizikë, vendas e të huaj";
- VKM nr. 1108, date 30.12.2015 "Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe Administrimit të ujërave të Bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit";

- Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.1, datë 12.1.2007 *“Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor”*;
- Udhëzim i Ministrit të Financave **Nr.32, datë 31.12.2013**, *“Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”*, i ndryshuar.
- Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.26, datë 4.09.2008, *“Për taksat kombëtare”*, i ndryshuar.
- Udhëzim i Përbashkët (Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë) Nr. 655/1, datë 06.02.2007 *“Për Përcaktimin e Uniformitetit të Standardeve Procedurale dhe të Raportimit të Sistemit të taksës Vendore”*;
- Udhëzim i Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 6756, datë 3.9.2015 *“Për zbatimin e vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”*, i ndryshuar;
- Udhëzim nr.30, datë 27.12.2011, *“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”*, i ndryshuar;
- Udhëzuesi i Ministrit për Çështjet Vendore nr. 541/1, date 31.12.2015 *“Udhëzues për zbatimin e VKM nr.1108 dat.30.12.2015 “Për transferimin nga MBZHRAU tek bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme”*.
 - VKM nr 662 date 21.09.2016 *“Per miratimin e tarifave te perdorimit te ujit dhe shkarkimeve te lengeta”*
 - Udhëzimit Nr 24 datë 02.09.2008 *Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”*i ndryshuarLigjin Nr. 115/2014 *“Për Ndarjen Administrative Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”*, Ligjin nr.10465, datë 29.09.2011 *“Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”*,i ndryshuar,
 - VKM-në nr. 132, datë 07.03.2018 *“Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”*,
 - Nr 970, datë 02.12.2015 *“Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licensave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, i ndryshuar me VKM nr 344 datë 19.04.2017,*

VENDOSI:
Miratimin e paketes fiskale 2020

Paketa Fiskale

Kapitulli I: Taksat vendore

Ky kapitull trajton taksat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:

- Lloji, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

TAKSAT DHE TARIFAT E APLIKUESHME NE BASHKINE SHIJAK PARAQITEN ME POSHTE :

- Tatimi i thjeshtuar mbi BV;
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja;
- Taksa e pasurisë;
- Taksa për transferimin e pasurisë së patundshme;
- Taksa për automjetet/mjetet e përdorura;
- Taksa e zënies së hapësirave publike;
- Taksa e tabelës/reklamat;
- Tatimi mbi te ardhurat personale.
- Taksa të përkohshme;
- Tarifa për shërbime;
- Tarifa te Drejtorise se Kontrollit te Zhvillimit te Teritorit
- Tarifa per sherbimin veterinar
- Tarifa per sherbimin ne fushen e Transportit
- Tarifa parkimi
- Tarifa per licensen per tregtim te naftes bruto e nenprodukteve te saj
- Tarifat ne sektorin e bujqesise e pyjeve
- Tarifa sherbimi nga institucionet, arsim, kulture, sport etj
- Tarifa sherbimi nga MNZ
- Tarifa per zenien e hapësirave publike
- Tarifa te perkohshme
- Tarifat per tregun e lire
- Tarifa per sherbime administrative
- Gjoha per mos shlyerje ne afat te detyrimeve
- Gjoha per shkelje e kundravajtje administrative

I.1 Tatim i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Baza e taksës/tatimi: Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës tatimore vjetore përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Niveli i tatimit: Nivelet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël paraqiten si

Tabela 1: Nivelet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël për vitin 2020

	Shkalla Tatimore	Njësia	Niveli Ligjor i Tatimit	
			NJA Shijak	NJA të tjera
A	Me qarkullim vjetor nga 0 - 5.000.000 lekë	lekë/vit	0	0
B	Me qarkullim vjetor nga 5.000.001 – 8.000.000 lekë	lekë/vit	5 % e fitimit	5 % e fitimit

Mënyra e pagesës: Tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore ose në Postën Shqiptare, këstet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të biznesit të vogël, brenda datës 20 prill, për muajt: janar, shkurt e mars; brenda datës 20 korrik, për muajt: prill, maj e qershor; brenda datës 20 tetor, për muajt: korrik, gusht e shtator; dhe brenda datës 20 dhjetor, për muajt: tetor, nëntor dhe dhjetor.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës/tatimit: Drejtoria Rajonale Tatimore, në rolin e agjentit tatimor, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

Për këtë shërbim Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrësi përfiton një komision prej 1 % të të ardhurave të mbledhura.

I.2 Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo

përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi ndërtesën
- Taksa mbi truallin

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë (ndërtesë, tokë bujqësore, truall) përdoruesi i pasurisë bën një vetë deklaram të sipërfaqes pranë bashkisë. Bashkia nëpërmjet komisionit të ngritur mund të vlerësojë sipërfaqen e taksueshme.

I.2.1 Taksa mbi ndërtesat

Baza e taksës: mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave, në bazë të vjetërsisë së ndërtesës, mund të specifikojë nënkategori përkatëse.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke përdorur të dhënat e mbledhura për ndërtesën/njësine pasurore, përcaktojnë bazën e taksës dhe llogarisin shumën e taksës vjetore të ndërtesës për t'u paguar nga çdo taksapagues. Baza e llogaritjes së taksës së ndërtesës është vlera e ndërtesës/njesisë pronësore, përcaktuar me një nga metodat e parashikuara në këtë metodologji. Për efekt të llogaritjes së taksës për ndërtesën/ njësi pronësore, baza e taksës shumëzohet me shkallën në përqindje të taksës së miratuar me ligj.

Shkalla e taksës: mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës është si më poshtë:

- a) 0.05%** për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim
- b) 0.2%** për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike
- c) 30%** e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur të përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi

Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.

Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".

Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.

Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata deri në një vit, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë (ndërtesë, tokë bujqësore, truall) përdoruesi i pasurisë bën një vetëdeklarim të sipërfaqes pranë bashkisë. Bashkia nëpërmjet komisionit të ngritur mund të vlerësojë sipërfaqen e taksueshme.

Detyrimi për pagesë

Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit më sipër.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës

Struktura e ngarkuar për llogaritjen e taksës mbi ndërtesat, për të gjitha kategoritë, është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë. (Agjenti tatimor)

Përjashtohen nga pagesa e taksës së ndërtesës

1. *Pronat e shtetit dhe të njesive të qeverisjes vendore që përdoren për qëllime jo fitimprurëse*
2. *Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të këshillit të ministrave, në administrimin e shoqërive publike shtetërore.*
3. *Ndërtesat e banimit që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara*
4. *Banesat Sociale në pronësi të bashkive*
5. *Pasuritë e paluajtshme –ndërtesa, prona e subjekteve juridike ose fizike që në bazë të marrveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale*
6. *Ndërtesat që përdoren nga komunitet fetar, në funksion të veprimtarisë së tyre*
7. *Strukturat akomoduese "Hotel/Resort me kater dhe pesë yje, status special sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtur të një marke të rregjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "Brandname"*

8. Ndertesat e banimit ,te deklaruar si vendbanim nga kryefamiljaret qe perfitojne vetem pension pleqerie/pension social ,kur familja e tyre perbehet vetem nga pensioniste,ose dhe me persona ne ngarkim te tyre ,qe jane te paafte per pune”
9. Ndertesat e banimit te kryefamiljareve qe trajtohen me ndihme ekonomike
10. Ndertesat kulturore ,nen mbrojtje te perkohshme ose te perhershme ,per kohen ne te cilen deklarohet mbrojtja ,sipas legjislacionit te fuqi per monumentet e kultures dhe /ose trashegimine kulturore,te cilat perdoren vetem per qellime jofitimpruese.

Niveli i miratuar i taksës së ndertesës është i njëjti në të gjitha njësitet administrative të Bashkisë Shijak ,Nj.A Shijak ,Nj.A.Xhafzotaj,Nj.A. Maminas,Nj.A.Gjepale me reduktim të shkallës së taksës me 20 % për ndërtesat që përdoren/shfrytëzohen për qëllime banimi dhe rritje të shkallës së taksës me 30% për ndërtesat që përdoren/shfrytëzohen për veprimtari ekonomike si me poshte :

	Kategoritë dhe nënkatëgoritë e ndërtesave	Njësia	Niveli I taksës mbindertesat	Niveli I Miratuar
1.	Ndertesat Banimi	Lek/m ² /sip. Nder	$41.000 \times 0.05\% = 20.5 \text{ l/m}^2$	$41.000 \times 0.04\% =$ <u>16.40/m²</u>
2.	Veprimtari tregtare dhe shërbime	Lek/m ² /sip. Nder	$41.000 \times 1.5 \times 0.2 = 123 \text{ l/m}^2$	$41.000 \times 1.5 \times 0.36 =$ <u>159.91/m²</u>
3.	Parkim I mbuluar dhe bodrume	Lek/m ² /sip. Nder	$41.000 \times 0.2\% \times 70\% = 57.4 \text{ l/m}^2$	$41.000 \times 70\% \times 0.26\% =$ <u>74.621/m²</u>
4.	Parkim I hapur	Lek/m ² /sip. Nder	$41.000 \times 0.2\% \times 30\% = 24.61 \text{ l/m}^2$	$41.000 \times 30\% \times 0.26\% =$ <u>31.981/m²</u>
5.	Veprimtari industriale	Lek/m ² /sip. Nder	$41.000 \times 0.2\% \times 50\% = 41 \text{ l/m}^2$	$41.000 \times 50\% \times 0.26\% =$ <u>53.31/m²</u>

6	Ndertesaqeperdoren ne bujqesi e blegtoriper per magazinimin ,...	Lek/m2/sip. Nder	$41.000 \times 0.2\% \times 30\% = 24.61/m^2$	$41.000 \times 30\% \times 0.26 =$ <u>31.981/m2</u>
7	Ndertesat e privatizuara per banim	Lek/m2/sip. Nder	$41.000 \times 0.05\% \times 70\% = 14.35$ <u>1/m2</u>	$41.000 \times 0.035\% =$ <u>14.351/m2</u>

Zona Fiskale	Shkalla e taksës per ndertesën/njesinë pronësore qe perdoret/shfrytezohe per:					
	Banim		Veprimtari Ekonomike			
	Shkalla e taksës sipas VKM 132	Ndryshimi I shkalles se taksës I miratuar	Shkalla e taksës e miratuar	Shkalla e taksës sipas VKM 132	Ndryshimi I shkalles se taksës I miratuar	Shkalla e taksës e miratuar
Shijak	0.05%	-20%	0.040 %	0.2 %	+ 30%	0.26%
Maminas	0.05%	-20%	0.040 %	0.2 %	+ 30%	0.26%
Khafzotaj	0.05%	-20%	0.040 %	0.2 %	+ 30%	0.26%
Gjepalaj	0.05%	-20%	0.040 %	0.2 %	+ 30%	0.26%

I.2.2 Taksa mbi tokën bujqësore

Përkufizimi: “*Tokë bujqësore*” është toka e përcaktuar si e tillë në regjistrin e zyrave të regjistrimit të pasurisë.

Baza e taksës: Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumenteve të pronësisë, formularit nr. 6, aktit të pronësisë, certifikatës së regjistrimit të tokës.

Niveli i taksës mbi tokën bujqësore paraqitet si më poshtë:

Tabela 3: Niveli i taksës mbi tokën bujqësore për vitin 2020

Kategoritë mesatare të tokës bujqësore	Njësia	Niveli i taksës mbi tokën bujqësore
		Sipas ligjit
I	lekë/ha/vit	5,600
II	lekë/ha/vit	4,900

III	lekë/ha/vit	4,200
IV	lekë/ha/vit	3,600
V	lekë/ha/vit	3,000
VI	lekë/ha/vit	2,500
VII - X	lekë/ha/vit	1,800

Detyrimi për pagesë: Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor.

Përjashtime: Përjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura e ngarkuar për llogaritjen e taksës mbi tokën bujqësore, për të gjitha kategoritë, është Sektori i taksave dhe tarifave vendore pranë Bashkisë Shijak, inspektorët e taksave në cdo njësi administrative.

Ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë, për vlerësimin e kategorisë së tokës si dhe saktësimin dhe verifikimin e periudhës së mbjelljes me kultura drufrutore dhe vreshtari, për çdo fermer/fermë.

I.2.3 Taksa mbi truallin

Përkufizimi: Truall është një sipërfaqe toke, jo bujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, e miratuar për të ndërtuar mbi të.

Baza e taksës: Është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.

Niveli i taksës mbi truallin paraqitet si më poshtë:

Tabela 4: Niveli i taksës mbi truallin për vitin 2020

Taksa mbi truallin	Njësia	Niveli i taksës mbi truallin	
		Sipas ligjit	Niveli I Miratuar
Për qëllime banimi nga individët	lekë/m ² /vit	0,14	0.182
Për qëllime biznesi	lekë/m ² /vit	12	15.6

Detyrimi për pagesë: Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor. Sektori i taksave dhe tarifave vendore kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit më sipër.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Detyrimi për familjarët llogaritet nga inspektorët e taksave të popullsisë pranë bashkisë dhe njësive administrative Xhafzotaj, Maminas dhe Gjepalë.

Deri në paraqitjen e dokumentacionit të pronësisë ose vetëdeklarimit të sipërfaqes së truallit, detyrimi vjetor referues i taksës së truallit për familjet llogaritet për një sipërfaqe prej 135 m².

Detyrimi për biznesin llogaritet nga Sektori i taksave dhe tarifave vendore, dhe shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë, brenda datës 20 prill të vitit fiskal.

Deri në paraqitjen e dokumentacionit të pronësisë ose vetëdeklarimit të sipërfaqes së truallit, detyrimi vjetor referues i sipërfaqes së truallit për bizneset llogaritet në bazë të sipërfaqes së ndërtesës së aktivitetit.

I.3 Taksa e fjetjes në hotel

Përkufizimi: Strukturat akomoduese do të përfshijnë kategoritë si më poshtë: a)“Bujtinë”; b)“Fjetinë” (Hostel); c)“Kamping”; ç)“Hotel”; d)“Motel”; dh)“Resort”; e)“Qendër kurative”; ë)“Fjetje dhe mëngjes” (B&B).

Secila kategori e strukturave akomoduese klasifikohet me sistem të veçantë, e shoqëruar me shenjat dalluese përkatëse, sipas përcaktimit të mëposhtëm: “Bujtinë” Standard, “Fjetinë” Standard, Komfort; “Kamping” Standard, “Hotel” dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje; “Motel” Standard, Komfort, Superior; “Resort” tre yje, katër yje, pesë yje; “Qendër kurative” dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje; “Fjetje dhe mëngjes” (B&B) Standard, Komfort, Superior.

Baza e taksës: Është numri i netëve të qëndruara në hotel për person.

Niveli i taksës se fjetjes në hotel paraqitet si më poshtë:

Tabela 5: Taksa e fjetjes në hotel për vitin 2020

Taksa e fjetjes në hotel	Njësia	Niveli i taksës së fjetjes në hotel
Hotel me 4-5 yje	lekë/natë qëndrimi/për person	105
Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	lekë/natë qëndrimi/për person	35

Detyrimi dhe këstet e pagimit: Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.

Detyrimi derdhet për bashkinë brenda datës 5 të muajit pasardhës nga subjekti përkatës.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Sektori i taksave dhe tarifave vendore.

4.	Per ndërtesat ,te cilat jane ne process legalizimi	0.5	<u>0.5%</u>
5.	Përndërtesat ,që destinohen per qellimebanimi ne zonatmalore	0-3 % te vleres se investimit	<u>3%</u>

I.5 Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë *për ndërtesat* është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë *për pasuritë e tjera të paluajtshme* është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës përcaktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 97 %. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Niveli i taksës: Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Tabela 7: Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme për vitin 2020

Kategoritë e ndërtesave	Njësia	Bashkia Shijak
Ndërtesa banimi	Lekë/m ²	100
Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	Lekë/m ²	300
Ndërtesa të tjera	Lekë/m ²	200

Detyrimi për pagesën: Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Mënyra e mbledhjes: Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila në rolin e agjentit të taksës përfiton 3% të shumës së arkëtuar dhe *diferencën e derdh për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë Shijak, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.*

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë të bëjë rakordimet dhe planifikimin e të ardhurave me ZRPP.

I.6 Taksa vjetore e mjeteve të përdorura

Baza e taksës: është lloji i mjetit të transportit rrugor

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Struktura e mbledhjes së kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore, **njezetepese përqind (25 %)** të të ardhurave vjetore nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Shijak në llogarinë e degës së thesarit.

I.7 Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare

Baza e taksës: Janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Struktura e mbledhjes e kësaj takse është Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor. Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit, pese perqind (5%) e të ardhurave të realizuara nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Shijak në llogarinë e degës së thesarit.

I.8. Taksa e tabelës

Baza e taksës: Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet që duhet të vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike të lejuara ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime identifikimi.

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulanteve. Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit harton planin për vendosjen e mundshme të Tabelave për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike.

Tabela 8: Taksa e tabelës për vitin 2020

Nr		Nj/matëse	Bashkia Shiak
I	Taksë tabelle për qëllimc identifikimi,te veprimtarise se subjektit të trupëzuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri ose logoja dhe/ose aktiviteti i biznesit).Ne rastin e perdorimit te me shume se nje tabelle,vetem njera konsiderohet e tille.		
a	<i>deri në 2 m2</i>	leké/m2/vit	0
b	■mbi 2 m2 deri 10 m2		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	leké/m2/vit	7,000
	•me ndriçim té thjeshtë	leké/m2/vit	11,500
	•elektron ike	leké/m2/vit	15 000
c	mbi 10 m2 deri 20 m2		
	•e thjeshtë (pa ndriçim)	leké/m2/vit	5 950
	-me ndriçim té thjeshtë	leké/m2/vit	9 775
	-elektron ike	leké/m2/vit	12 750
ç	mbi 20 m2 deri 40 m2		
	-e thjeshte (pa ndriçim)	leke/m2/vit	3 850
	•me ndriçim té thjeshtë	leké/m2/vit	6 325
	-elektron ike	leké/m2/vit	8 250
d	mbi 40 m2		
	•e thjeshtë (pa ndriçim)	leké/m2/vit	2,800
	-me ndriçim te thjeshte	leke/m2/vit	4 600
	•elektron ike	leké/m2/vit	6 000
II.	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim.Keto tabela sherbejne vetem si tabela orientuese dhe vendosen jashte teritorit ku zhvillohet aktiviteti ,per orientim te klienteles apo publikut drejt vendndodhjes se veprimtarise se		
	-Tabela identifikuese	leké/m2/vit	120
III.	Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizshme e vendosur me pamje ballore ose joballore ne vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit ,ose ne hapësira te tjera publike apo private,si taraca ,llozha,ballkone,fasada,trotuare,shtylla,mbajtese ajrore mbi pjeset te rrugeve qytetase apo kombetare etj,qe kane permbajtje reklamimi per vete apo te tretet dhe qe sherben si reklame per te njoftuar ,per te terhequr vemendjen ose per te joshur bleresit.		
	•e thjeshtë (me/pa ndriçim)	leké/m2/vit	13 500

	-Elektronike	Ieké/m2/vit	27 000
IV.	Tabela ne funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.		
	-té té gjitha llojeve dhe përmasave	Ieké/m2/ditë	1,000

Për subjektet taksapaguese që vendosin më shumë se një tabelë identifikuese, vetëm njëra nga tabelat identifikuese do të konsiderohet si e tillë, kurse tabela tjetër do konsiderohet si reklamë. Cdo tabelë reklamimi që kalon sipërfaqen **35 m2, do të konsiderohet sikur është 35 m2 dhe** shuma e taksës llogaritet dhe paguhet vetëm për këtë sipërfaqe, pavarësisht madhësisë së saj në m2. Në kategorinë e reklamës kuptojmë cdo publicitet, formë promovimi që shërben për të njoftuar, tërhequr vëmendjen ose joshur blerësit, e vendosur në pamje jo balore, ne tarraca, lozhë, ballkone, në pjesë të rrugës, shtylla etj që kanë përmbajtje me qëllime reklamimi **për vete ose të tretë.**

Detyrimi dhe këstet e pagesës: Detyrimi për Taksën e Tabelës për Kategorinë 1 dhe 2 është vjetor.

- Për “Kategorinë 1” për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet brenda datës 20 prill të vitit fiskal. Për subjektet që duan të identifikohen me tabelë të re pas datës 20 prill, detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë për periudhën nga deklarimi.
- Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet që nga muaji korrent që subjekti regjistrohet pranë QKR dhe paguhet menjëherë. Taksa e tabelës për qëllime identifikimi paguhet për çdo njësi ku subjekti zhvillon aktivitetin nga muaji korrent që regjistrohet pranë QKR.
- Në rastin e më shumë se një tabele, pavarësisht nga vendndodhja, vetëm njëra do të konsiderohet si tabelë me qëllime identifikuese, ndërsa Tabelat e tjera do të konsiderohen si Tabela me qëllime reklamuese.
- Për “Kategorinë 2” për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet brenda datës 20 prill të vitit fiskal. Për subjektet e reja detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë sipas periudhës së përcaktuar në kontratën e nënshkruar me strukturat përkatëse të Bashkisë Shijak.
- Për “Kategorinë 3” detyrimi llogaritet sipas ditëve të përcaktuara në lejen përkatëse të lëshuar nga strukturat përkatëse të Bashkisë Shijak dhe paguhet menjëherë.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës është Sektori i taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Shijak.

Për Kategorinë 2 dhe 3. Tabelë për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike: Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit ngarkohet për shqyrtimin e kërkesës nga

ana e subjektit, si dhe për hartimin e dokumentacionit të plotë të marrjes së lejes për vendosjen e reklamave dhe përcaktimin e sipërfaqeve objekt taksimi. Kjo Drejtori njofton në mënyrë periodike Drejtorinë e të Ardhurave në lidhje me të gjitha ndryshimet në sipërfaqe (shtesa apo pakësime) që janë objekt i kësaj takse.

I.9.Tatimi mbi te ardhurat personale

Ku perfshihet taksa vendore mbi te ardhurat vetjake,taksa mbi te ardhurat e krijuara nga dhuratat ,trashegimite,testamentet ose lotarite vendore.2% e te ardhurave nga kjo takse i kalojne Bashkise

Kapitulli II: TARIFAT VENDORE

Ky kapitull trajton tarifat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:

- Llojit të shërbimit, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

II.1 Tarifa e shërbimeve (pastrimit dhe largimit të mbeturinave ,ndricim)

Përkufizimi: Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Shijak dhe njësive të saj administrative.

Niveli i tarifës së pastrimit: Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë:

Tabela9 **Tarifa e shërbimeve administrative(pastrimit dhe largimit të mbeturinave ,ndricim)**për familjet për vitin 2020

Nr.	Kategoritë: FAMILJARET	Niveli i Tarifës
		Lekë/vit
I.1	Njësia Administrative Shijak	2.000
I.2	Njësitë e tjera Administrative	
	<i>Xhafzotaj</i>	2.000
	<i>Maminas</i>	2.000
	<i>Gjepale</i>	1.300

Tabela 1: Tarifë pastrimi për institucione për vitin, 2020

II	Tarifë pastrimi për institucione	Njësia	Tarifa
	Institucione shtetërore administrative, arsimore, kulturore, shëndetësore, sportive, etj.	lekë/vit/njësi	5,200

Tabela 11: **Tarifa e shërbimeve (pastrimit dhe largimit të mbeturinave ,ndricim)**për bizneset për vitin, 2020

III	BIZNESI	Biznes i vogël	Biznes i madh
III. 1	Njësi tregtare dhe Shërbimi në Njësinë Administrative Shijak	12,000	36,000
III. 2	Njësi tregtare dhe shërbimi në Njësitë e tjera Administrative		
	Xhafzotaj	12,000	36,000
	Maminas	10,000	36,000
	Gjepalaj	10,000	36,000
III. 3	Njësi tregtare për tregtim karburanti	17,000	56,000
III. 4	Njësi prodhimi		
	Njësi prodhimi në Njësinë Administrative Shijak	12,000	56,000
	Xhafzotaj	12,000	56,000
	Maminas	10,000	56,000
	Gjepalaj	10,000	56,000
III. 5	Subjekte transporti	10,000	36,000
III. 6	Subjektet e ndërtimit (ne cdo adrese te rregjistruar ne QKB)		81,000
III. 7	Subj. përp. metale, fonderi, bitum e të ngjashme		106,000
III. 8	Subj. përp, beton, inerte, gurë e të ngjashme		56,000
III. 9	Subj. tregtimi, beton, inerte, gurë e të ngjashme		56,000
III. 10	Subj. përp. mbetje plastike, letër, dru etj.		66,000
III. 11	Shoqata, fondacione, ente të ndryshme shtetërore, organizata joqeveritar		
	Institucione Administrative Publike		7,000
	Organizata të tjera jofitimprurëse		5,000
III. 12	Profesione të lira		
	Profesone të lira	7,000	16,000
III. 13	Ambulant Subjekte që nuk kanë një vendndodhje fikse, taksi, tregtia ambulante në tregje publike dhe private.	7000	

III.14	Subjekte qe shrytezojne liqenet	12.000	36.000
III.15	Ferma bujqesore	12.000	36.000

Baza e tarifës: Vlera në lekë sipas kategorive e cila duhet të afrohet me koston e shërbimit.

Detyrimi për pagesën: Detyrimi për Tarifën e pastrimit është vjetor.

Kategoria I. “Familjarët”: Detyrimi paguhet brenda 6 mujorit të I-rë për çdo familje. Në momentin e kalimit të Ndërmarrjes së Ujësjetës në vartësi të Bashkisë kjo tarifë do të paguhet në këste mujore njëkohësisht me pagesën e konsumit të ujit. Për çdo familje të re, afati i pagesës së tarifës së pastrimit do të jetë 30 ditë nga dita e regjistrimit të saj në Zyrën e Gjendjes Civile përkatëse dhe detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit të saj.

Kategoria II, III.

Detyrimi paguhet brenda datë 20 prill. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 Prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit pranë QKR. Për çdo subjekt detyrimi llogaritet për çdo vendndodhje të aktivitetit.

